



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
DHOMAT E SHKALLËS SË DYTË

Numri i lëndës: 2023:191033
Datë: 29.04.2024
Numri i dokumentit: 05630476

Kom.Dh.Shk.II.nr.22/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së dytë, me gjyqtarin individual Ramush Bardiqi, në çështjen përmbartimore të kreditorit Dogana e Kosovës me seli në Prishtinë, Lagia Kalabria, rr. "Rexhep Krasniqi", nr. 1, kundër debitorit Kompania "Niki Automobile" Sh.P.K., me numër unik identifikues 811427667 dhe me seli në Pejë, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit B.M., avokat nga Gjakova, në çështjen përmbartimore, për shkak të borxhit në bazë të dokumentit përmbartimor, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1419/23 dt. 02.11.2023, më datën 29.04.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e debitorit Kompania "Niki Automobile" Sh.P.K., me numër unik identifikues 811427667 dhe me seli në Pejë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale- Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.1419/23 dt. 02.11.2023, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Komerciale - Dhomat e Shkallës së Parë, KPPP.nr.1419/23 dt. 02.11.2023 e ka refuzuar në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit "Niki Automobile" Sh.P.K., me numër unik identifikues 811427667 dhe me seli në Pejë, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 345/23, i lejuar më datë 21.08.2023, nga Përmbartuesi Privat Besnik F. Nuhiu. Ndërsa në piken II ka vendosur që Urdhri Përmbartimor P.nr. 345/23, i lejuar më datë 21.08.2023, nga Përmbartuesi Privat Besnik F. Nuhiu, mbetet në fuqi.

Ankesë ka paraqitur në afat ligjor debitori (*me pretendimet si në ankese*) me propozimin që të aprovohet si e bazuar ankesa , ndërsa aktvendimi KPPP.nr.1419/23 dt. 02.11.2023 të prishet ose të ndryshohet, ashtu që të aprovohet në tërësi si i bazuara prapësimi i debitorit dhe të shfuqizohet urdhrin përmbartimore P.nr.345/23 të datës 21.08.2023.

Përgjigje në ankesë nuk ka parashtruar kreditori.

Gjyqtari individual i Gjykatës Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3 par.2 të Ligjit nr.04/L-139 për procedurën përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 të LPK-së, gjeti se:

Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Dogana e Kosovës, mbi bazën e dokumentit përmbartimor; Vendimit Nr.03.1.1-2023-17, të datës 31.01.2023, ka lejuar Urdhrit Përmbartimor P.nr. 345/23, të datës 21.08.2023, me të cilin është obliguar debitori “Niki Automobile” Sh.P.K., që menjëherë pas pranimit të urdhrit, kreditorit t’ia paguaj shumën prej 21,356.70 €, së bashku me shpenzimet e procedurës përmbartimore.

Debitori, përmes përfaqësuesit të autorizuar, brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me të cilin e ka kundërshtuar në tërësi urdhrin përmbartimor, me arsyetim se i njëjti është i parregullt dhe pa efekt juridik, sepse propozimit për përmbartim nuk i është bashkangjitur origjinali apo kopja e vërtetuar e titullit ekzekutiv si dhe nuk e ka klauzolën ekzekutueshmërisë. Më tej, ka theksuar se organi përmbartimor ka zbatuar gabimisht të drejtën materiale ngase propozimi për përmbartim i kreditorit nuk përmban kërkesat ligjore nga neni 38 të LPP-së. Ndërsa, ka shtuar se debitori ndaj vendimit në fjalë ka paraqitur padi për inicimin e konfliktit administrativ për shkak se i njëjti është nxjerr në kundërshtim me ligjin dhe se ekzekutimi i të njëjtit debitorit do të shkaktonte dëm të riparueshëm. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta aprovoj si të bazuar, ndërsa urdhri përmbartimor të anulohet.

Kreditori, në përgjigje në prapësim ka theksuar se urdhri përmbartimor është lejuar në bazë të aktvendimit të Doganës së Kosovës, i cili përmban vulën e të njëjtës dhe i njëjti është i formës së prerë dhe ekzekutiv, duke përmbushur kushtet sipas nenit 23.2 dhe nenit 24.1 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore. Më tej, ka theksuar se padia e iniciuar nga debitori në procedurën e konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e tij. Për këto arsye, gjykatës i ka propozuar që prapësimin e debitorit ta refuzoj si të pabazuar, ndërsa urdhri të mbetet në fuqi.

Gjykatës Komerciale- Dhoma e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e atakuar KPPP.nr.1419/23 dt. 02.11.2023 e ka refuzuar në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit “Niki Automobile” Sh.P.K., me numër unik identifikues 811427667 dhe me seli në Pejë, ushtruar ndaj Urdhrit Përmbartimor P.nr. 345/23, i lejuar më datë 21.08.2023, nga Përmbartuesi Privat Besnik F. Nuhiu. Ndërsa në piken II ka vendosur që Urdhri Përmbartimor P.nr. 345/23, i lejuar më datë 21.08.2023, nga Përmbartuesi Privat Besnik F. Nuhiu, mbetet në fuqi, duke vendosur me decidivishtë sikur në dispozitiv të të njëjtit.

Vlerësimin dhe qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, e aprovon si të rregullt dhe të ligjshëm, për arsye se aktvendimi i atakuar nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182

paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe se drejtë është zbatuar e drejta materiale, e të cilat shkaqe ankimore gjykata e shkallës së dytë, në bazë të nenit 194 të LPK-së, i vlerëson edhe sipas detyrës zyrtare.

Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë nuk i ka pranuar pretendimet ankimore për shkelje të dispozitave të ligjit të procedurës përbarimore, pasi që gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar drejtë provat të cilat i ka pasur në dispozicion në shkresat e lëndës të ofruara nga ndërgjyqësit, ka vendosur drejtë në dispozitiv të aktvendimit, duke dhënë arsye përkatëse në pjesën arsyetuese të aktvendimit të atakuar dhe drejtë ka aplikuar edhe Ligjin e Procedurës Përbarimore,

Kjo gjykate vlerëson se në rastin konkret Aktvendimi i Doganës së Kosovës me Nr.03.1.1-2023-17, i datës 31.01.2023 për shumën në lartësi prej 21,356.70 €, në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përbarim, i plotëson kushtet për të qene dokument përbarimor me titull ekzekutiv, sepse i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 21 dhe 22 të LPP-së.

Gjykata Komerciale, Dhomat e shkallës së dytë, vlerëson se dokumenti mbi të cilin është lejuar përbarimi, Aktvendimi i Doganës së Kosovës, përben bazën juridike për caktimin e përbarimit, pasi që paraqet titull ekzekutiv sipas nenit 21 të Ligjit për Procedurën Përbarimore, në të cilin përcaktohet se “ *Organi përbarues e cakton, përkatësisht e zbaton përbarimin vetëm në bazë të dokumentit përbarues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshme, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër*” dhe nenit 22 par.1 pika 1.2 të LPP-së, me të cilin përcaktohen dokumentet përbaruese siç janë “*Vendimi përbarues i dhënë në procedurë administrative dhe akt pajtimi*”. Në rastin konkret Vendimi me Nr.03.1.1-2023-17, i datës 31.01.2023 i përmban elementet e një vendimi të organit administrativ, dhe se e ka cilësinë e dokumentit përbarues sipas nenit 21 dhe 22 par.2, LPP-së. Po ashtu dokumentit/vendimit Nr.03.1.1-2023-17 nuk i mungon forma e aktit administrativ, struktura dhe elementet e detyrueshme të aktit administrative të përcaktuar me dispozitat e nenit 47 dhe 48 të (Ligjit 05/L-031) për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe si të tillë mund të konsiderohet dokument përbarimor sipas nenit 22 të LPP-së.

Andaj, Gjykata Komerciale – dhoma e shkallës së dytë vlerëson se gjykata e shkallës së parë drejte ka vendosur kur e ka refuzuar në tërësi prapësimin e debitorit, me arsyetimin se në bazë të shkresave të lëndës rezultojnë se vendimi mbi të cilin përbaruesi privat e ka lejuar urdhrin përbarimor të debitorit me Nr.03.1.1-2023-17, i datës 31.01.2023 paraqet dokument përbarimor në kuptim të dispozitave të LPP-së, për shkak se përmban vulën e ekzekutueshmërisë dhe plotfuqishmërisë, si dhe vendimi mbi bazën e të cilit është nxjerrë urdhri përbarimor i plotëson kushtet në kuptim të nenit 22 par.1 të Ligjit për Procedurën Përbarimor.

Dhoma e shkallës së dytë e Gjykatës Komerciale, i vlerësoi të gjitha pretendimet ankimore të debitorit por të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe, për çka vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi. Nëse pala debitorë për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore ka mundur ti shkaktohet apo mund ti shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e

mos kryerjes së përmbartimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtën e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente.

Andaj, duke marr parasysh pretendimet ankimore, të cilat konsistojnë ndaj aktvendimit të ankimuar, gjykata e shkallës së dytë konsideron se këto pretendimet ankimore janë të pabazuara, ngase nuk kemi të bëjmë me shkelje thelbësore të dispozitave të Ligjit të Procedurës Kontestimore, të cilat shkelje kjo gjykatë i vështron sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, dhe as të Ligjit të Procedurës Përmbartimore. Andaj me të drejtë gjykata e shkallës së parë e ka refuzuar prapësimin e debitorit dhe e ka lënë në fuqi urdhrin për caktimin e përmbartimit të Përmbartuesit Privat, P.nr. 345/23, i lejuar më datë 21.08.2023.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika b) të LPK-së lidhur me nenin 17 të LPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS
Dhomat e shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.22/24 dt. 29.04.2024

Gjyqtari,
Dren Rogova